

**AKTI I THEMELIMIT TE  
SHOQËRISË ME PERGJGJËSI TË KUFIZUAR  
“LANEL” SH.P.K**

Themeluesi i Shoqërise qe nenshkruan me poshte:

- **ELTON ELEZI**, i biri i Arben-it, lindur me date 22/05/1988 ne Kavaje, Alb, banues ne Kavaje, i identifikuar me karte identiteti nr.personal **I80522106L**
- **TAULANT STEFI**, i biri i Lip -it, lindur me date 08/03/1988 ne Kavaje, Alb, banues ne Kavaje, i identifikuar me karte identiteti nr.personal **I80308019M**

**Kreu I**

**Te Dhenat mbi Shoqërin Tregtare**

**Neni 1**

Ne Kavaje, sot, me date **28/Mars/2023**, bazuar ne vullnetin e tij te lire dhe te plote, ne perputhje me ligjin nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, vendosi te hartojne kete statut per funksionimin e shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar; “LANEL” SH.P.K, me Administrator te vetem **ELTON ELEZI**.

Ne baze te kushteve qe vijojne:

**Adresa e shoqerise:** Autostrada kavaje Durres, ZK Nr 8551 , pasuria nr.1/10 , Bashkia Kavaje.

**Objekti i Veprimtarise:** Ne fushen e projektimit: projektme objekte banimi, industriale, turistike, bujqesore pejsazhi, sistemime te te gjitha llojeve, lulishte, vepra arti, projekte interiere, mobilim etj. Ne fushen e ndertimit; ndertime civile, industrial, turistike, bujqesore deri ne V kate dhe mbi V kate, ndertime hekurudhore, punime mbi shina dhe traversa, germime dhe punime dheu, punime per prishjen e ndertimeve, sistemime, tarracime, prodhim elementesh te parafabrikuara betoni e betonarme dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, impjante hidro-sanitare, kuzhina, lavaneri, si dhe mirembajtja e tyre. Punime rifiniture te muratures dhe çdo gje tjeter te lidhura me to, rifinitura me material druri, plastik, metalik, inox, xhami etj, si dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese. Rikonstruksione godinash civile, industriale, bujqesore e ekonomike, veshje fasadash te te gjitha llojeve, termike, dekorative, strukturore etj. Punime mermeri te te gjitha llojeve te thjeshte dhe dekorativ. Materiale dhe punime per hidroizolime te te gjitha llojeve nentokesore dhe per objekte civile, industrial, etj. Dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, punime elektrike, linja TL, TU, impiante

elektrike, ndertime per nenstacionet, kabinat e transformatoreve, linja te TN te mesem dhe shprendarjen e energjise, telefoni, citofoni, internet, sisteme vezhgimi, sisteme monitorimi dhe mirembajtja e tyre. Restaurimi ndertesave monument 2 kulture, punime restaurimi ne vepra arkeologjike, ndertime gazsjelles, naftesjelles, ndertime diga, galeri, tunele, punime mbrojtjeje te sistemit hidraulike-cimentime, kanale e impiante vaditje, higjenike, punime karpentiere druri dhe metali, instalimet e impianteve nenpresion, instalimet per nenstacionet, kabinat e transformatoreve etj. Punime te inxhinierise se mjedisit, Rivelime topografike, punime topogjeodezike, punime ne siperfaqe te gjelberta parqe, lulishte, instalimi i impianteve vaditese, ngritese dhe transpotuese, ashensore, shkalle levizese etj. Shitje me shumice dhe pakice si dhe sherbimet e nevojshme per mbrojtjen nga zhurmat, material akustike, material per mbrojtjen nga rrezatimet X-RAY, pastrim i ujerave detar, liqenore dhe lumore, ndertim i impjanteve te ujit te pijshem dhe pastrimit te tij. Ndertim i impjanteve te grumbullimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane. Ne fushen e blerjes se shitjes se artikujve te ndryshem, shfrytezim pylli, ne fushen e pyllezimeve e permiresimeve dhe zbatimin e punimeve ne fushen e mbareshtimit te pyjeve, rrugeve pyjore dhe studim e projektim, shitje kancelarie etj. Ne fushen e tregtise importexporti, me shumice dhe pakice, te mallrave industrial, ushqimore, sherbime katering, perpunim, prodhim, tregtim i lendes se pare ushqimore dhe shperndarjes se saj, bujqesore dhe blektorale, veshmbathje, konfeksione, prodhim e tregtim te materialeve te ndertimit, inerte, rere, zhavorr punime gipsi, automjeteve, makinerive, projektim, instalim dhe mirembajtje per pajisje elektronike, pajisje, rrjete dhe sisteme te telekomunikacionit, pajisje software, sisteme dhe rrjeta te teknologjise se informacionit, pajisje dhe sisteme te dedektimit dhe mbrojtjes nga zjarri, pajisje dhe sisteme te kontrollit te trafikut ajror, tokesor dhe detar, pajisje dhe sisteme te vezhgimit, te mbikqyrjes dhe alarmit, pajisje, instrumenta dhe sisteme matese dhe kalibrues, pajisje dhe sisteme energjetike, pajisje dhe sisteme hidraulike dhe pneumatike, automjeteve, makinerive, pajisjeve hidrosanitare, mobiljeve, artikujve kozmetike, lendve te perpunuara e te paperpunuara, te bimeve medicinale, te lendes drusore, dyer, dritare, plastike, duraluminit, metalike etj, tregtim me pakic te karburanteve dhe vajrave lubrifikante, tapete dhe rrugica te te gjitha llojeve per objekte civile, industriale etj. Impjante teknologjik, termike dhe te kondicionimit, Import-eksport tregti me shumice e

pakice te kondicionereve, paisjeve elektroshtepiake. Shitje kondicionere, aspiratore te fuqive te ndryshme shtepiake dhe industriale, aksesore per aspirim, delageshtues, jonizues ajri, kaldaja, pajisje hidraulike dhe elektrike, ngrohesa dhe 3 radiatore elektrike, sisteme per matjen dhe monitorimin e temperaturave dhe lageshtires se ajerit ne ambjente te ndryshme. Sherbim, mirembajtje dhe riparim kaldaja, kondicionere, sistem ngrohje -ftohje me uje e gaz, gjenerator, ashensor, rrjetit elektrik dhe rrjetit hidraulik. Transport mallrash dhe udhetaresh brenda dhe jashte vendit. Ne fushen e ndertimeve, tregtim me pakice te karburanteve. Furnizim vendosje, sherbime dhe mirembajtje panele djellore. Blerje material didaktike, reagent te te gjitha llojeve dhe material te buta. Organizime event, qender kursesh. Vleresime te pasurive te paluajtshme, vleresime te tokave buqesore, pyjeve etj. Punime, materiale dhe sherbime te te gjitha llojeve qe jane te ligjshme dhe te miratuara ne legjislacionin Shqipetar. Per kryerjen e aktiviteteve te shoqerise se mesiperme per te cilin do te nevojitet leje perkatese, shoqeria eshte e detyruar te pajiset paraprakisht me kete leje nga organi kompetent

**Selia e Shoqerise:**

Autostrada kavaje Durres, ZK Nr 8551 , pasuria nr.1/10 , Bashkia Kavaje.

**Neni 2**

**Objekti**

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm (vetëm nëse është i përcaktuar):  
Ne fushen e projektimit: projektme objekte banimi, industriale, turistike, bujqesore pejsazhi, sistemime te te gjitha llojeve, lulishte, vepra arti, projekte interiere, mobilim etj. Ne fushen e ndertimit; ndertime civile, industria, turistike, bujqesore deri ne V kate dhe mbi V kate, ndertime hekurudhore, punime mbi shina dhe traversa, germime dhe punime dheu, punime per prishjen e ndertimeve, sistemime, tarracime, prodhim elementesh te parafabrikuara betoni e betonarme dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, impjante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, si dhe mirembajtja e tyre. Punime rifiniture te muratures dhe çdo gje tjeter te lidhura me to, rifinitura me material druri, plastik, metalik, inox, xhami etj, si dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese. Rikonstruksione godinash civile, industriale, bujqesore e ekonomike, veshje fasadash te te gjitha llojeve, termike, dekorative, strukturore etj. Punime mermeri te te gjitha llojeve te thjeshte dhe dekorativ. Materiale dhe punime per hidroizolime te te gjitha llojeve nentokesore dhe per objekte civile, industrial, etj. Dhe kompletimi me instalimet e nevojshme per to, punime elektrike, linja TL, TU, impiante elektrike, ndertime per nenstacionet, kabinat e transformatoreve, linja te TN te mesem dhe shprendarjen e energjise, telefoni, citofoni, internet, sisteme vezhgimi, sisteme monitorimi dhe mirembajtja e tyre. Restaurimi ndertesave monument 2 kulture, punime restaurimi

ne vepra arkeologjike, ndertime gazsjelles, naftesjelles, ndertime diga, galeri, tunele, punime mbrojtjeje te sistemit hidraulike-cimentime, kanale e impiante vaditje, higjenike, punime karpentiere druri dhe metali, instalimet e impianteve nenpresion, instalimet per nenstacionet, kabinat e transformatoreve etj. Punime te inxhinierise se mjedisit, Rivelime topografike, punime topogjeodezike, punime ne siperfaqe te gjelberta parqe, lulishte, instalimi i impianteve vaditese, ngritese dhe transpotuese, ashensore, shkalle levizese etj. Shitje me shumice dhe pakice si dhe sherbimet e nevojshme per mbrojtjen nga zhurmat, material akustike, material per mbrojtjen nga rrezatimet X-RAY, pastrim i ujerave detar, liqenore dhe lumore, ndertim i impjanteve te ujit te pijshem dhe pastrimit te tij. Ndertim i impjanteve te grumbullimit dhe trajtimit te mbetjeve urbane. Ne fushen e blerjes se shitjes se artikujve te ndryshem, shfrytezim pylli, ne fushen e pyllzimeve e permiresimeve dhe zbatimin e punimeve ne fushen e mbareshtimit te pyjeve, rrugeve pyjore dhe studim e projektim, shitje kancelarie etj. Ne fushen e tregtise importexporti, me shumice dhe pakice, te mallrave industrial, ushqimore, sherbime katering, perpunim, prodhim, tregtim i lendes se pare ushqimore dhe shperndarjes se saj, bujqesore dhe blektorale, veshmbathje, konfeksione, prodhim e tregtim te materialeve te ndertimit, inerte, rere, zhavorr punime gipsi, automjeteve, makinerive, projektim, instalim dhe mirembajtje per pajisje elektronike, pajisje, rrjete dhe sisteme te telekomunikacionit, pajisje software, sisteme dhe rrjete te teknologjise se informacionit, pajisje dhe sisteme te dedektimit dhe mbrojtjes nga zjarri, pajisje dhe sisteme te kontrollit te trafikut ajror, tokesor dhe detar, pajisje dhe sisteme te vezhgimit, te mbikqyrjes dhe alarmit, pajisje, instrumenta dhe sisteme matese dhe kalibrues, pajisje dhe sisteme energjetike, pajisje dhe sisteme hidraulike dhe pneumatike, automjeteve, makinerive, pajisjeve hidrosanitare, mobiljeve, artikujve kozmetike, lendve te perpunuara e te paperpunuara, te bimeve medicinale, te lendes drusore, dyer, dritare, plastike, duraluminit, metalike etj, tregtim me pakic te karburanteve dhe vajrave lubrifikante, tapete dhe rugica te te gjitha llojeve per objekte civile, industriale etj. Impjante teknologjik, termike dhe te kondicionimit, Import-eksport tregti me shumice e pakice te kondicionereve, paisjeve elektroshtepiake. Shitje kondicionere, aspiratore te fuqive te ndryshme shtepiake dhe industriale, aksesore per aspirim, delageshtues, jonizues ajri, kaldaja, pajisje hidraulike dhe elektrike, ngrohesa dhe 3 radiatore elektrike, sisteme per matjen dhe monitorimin e temperaturave dhe lageshtires se ajerit ne ambiente te ndryshme. Sherbim, mirembajtje dhe riparim kaldaja, kondicionere, sistem ngrohje -ftohje me uje e gaz, gjenerator, ashensor, rrjetit elektrik dhe rrjetit hidraulik. Transport mallrash dhe udhetaresh brenda dhe jashte vendit. Ne fushen e ndertimeve, tregtim me pakice te karburanteve. Furnizim vendosje, sherbime dhe mirembajtje panele djellore. Blerje material didaktike, reagent te te gjitha llojeve dhe material te buta. Organizime eventi, qender kursesh. Vleresime te pasurive te paluajtshme, vleresime te tokave buqesore, pyjeve etj. Punime, materiale dhe sherbime te te gjitha llojeve qe jane te ligjshme dhe te miratuara ne legjislacionin Shqiptar. Per kryerjen e aktiviteteve te shoqerise se mesiperme per te cilin do te nevojitet leje perkatese, shoqeria eshte e detyruar te pajiset paraprakisht me kete leje nga organi kompetent, Shoqeria sipas nevojave te aktivitetit ka te drejten e ushtrimit te cdo aktiviteti te ligjshem, te lejueshem per formen e shoqerise, e cila nuk ndalohet me ligj (sipas nenit 7 te Ligjit nr.990 1 ,dt.14.04-08).

### Neni 3

#### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pa përcaktuar (vetëm nëse është e përcaktuar):

### Neni 4

#### Selia

- Autostrada kavaje Durres, ZK Nr 8551 , pasuria nr.1/10 , Bashkia Kavaje.
- Adresa e faqes së internetit të shoqërisë është (nëse ka):
- Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon (nëse ka):

### Kreu II

#### Kapitali

### Neni 5

#### Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100.000** (njqind mije) Leke, (sipas ligjit kapitali nuk mund të jetë më i vogël se 100 lekë). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributin e tij të mëposhtme:
- Ortaket themelues jane **ELTON ELEZI**, zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme **51.000** (pesedhjetë e nje mije) Leke, që përben 51 % të kapitalit themeltar të shoqërisë, dhe ortaku tjeteter eshte **TAULANT STEFI**, zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme **49.000** (dyzete e nente mije) Leke, që përben 49 % të kapitalit themeltar të shoqërisë kontributi e ortakeve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

### Neni 6

#### Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

- Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
- Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.



- Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### Neni 7

#### Transferimi i kapitalit

- Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - d) dhurimit;
  - e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### KREU III

#### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

### Neni 8

#### Organi Vendimmarres

- Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
- Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton çdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
- Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “d” të kësaj pike;
  - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;



- i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë, mund të bëjë përfaqësimin dhe me videocall.
  - Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
  - Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### Neni 9

#### Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblese së Përgjithshme

- Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### Neni 10

#### Kuorumi

- Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.
- Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### Neni 11

#### Marrja e vendimeve



- Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje tjera si:
  - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve;
  - e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecuarisë së veprimtarisë;
  - f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - h) Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

## Neni 12

### Përgjithshme nga e drejta e votës

- Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës në se asambleja e përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## Neni 13

### Administrimi

- Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5-vjeçar, me të drejtë ripërtëritjeje, emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit:  
(emer, mbiemer, adresa):

dhe specimenët e nënshkrimit:




- **ELTON ELEZI**, i biri i Arben-it, lindur me date 22/05/1988 ne Kavaje, Alb, banues ne Kavaje, i identifikuar me karte identiteti nr.personal **I80522106L**

#### Neni 14

#### Kompetencat e Administratorëve

- Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
  - a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) Përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
  - c) Kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
  - e) Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f) Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - g) Raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
  - h) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:
  - a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5-(pese) % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5-(pese) % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - d) Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
  - e) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### Neni 15

#### Përgjegjësitë e Administratorit

- Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

- Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administratori detyrohet:
  - a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
  - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
  - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
  - d) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
  - e) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, kryen veprimet e mëposhtme:
  - a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
  - d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi pagueuse për të shlyer detyrimet;
  - e) jep kredi.
- Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.
- Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### Kreu IV

#### Viti financiar-ekspertet




### Neni 16

- Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

### Neni 17

#### Ekspertet

- Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko tregtare te shoqerise, ate gjithevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

### Kreu V

#### Prishja – riorganizimi i shoqërisë

### Neni 18

#### Prishja dhe likuidimi

- Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:
  - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 03.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
  - e) me vendim të gjykatës;
- Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “Shoqeri ne likuidim e siper”.
- Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.
- Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

### Neni 19



### Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

- Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

#### Neni 20

##### Baza Ligjore

- Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

#### Neni 21

##### Mosmarrëveshjet

- Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tregtarëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

### **ORTAKET**

#### **E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

**“LANEL” SH.P.K**

**ELTON ELEZI**



**TAULANT STEFI**

